



MA - 405 MATIFLEX



PAKETIMI

25 kg



RAPORTI I PERZIERJES

6-7 L / 25kg



KONSUMI

3-5 kg/m²

Përkufizimi

MA-405 MATIFLEX është një ngjitës elastik me bazë çimentoje i klasifikimit S1, me performance të lartë, me kohë të zgjatur punimi dhe pa rrëshqitshmëri vertikale, për pllaka qeramike dhe guri.

Veçoritë

- Ka forcë të lartë ngjitëse.
- Tepër elastik falë klasifikimit S1, rezistent ndaj ndryshimit të temperaturave.
- Mund të aplikohet në sipërfaqe vertikale edhe për lidhjen e pllakave të rënda, pa rrëshqitur.
- Ka kohë të zgjatur punimi.
- I lehtë për t'u krehur me mallë.

Aplikimi

- Sipërfaqja e zbatimit duhet të jetë kompakte dhe e pastër nga vaji apo graso si dhe mjaftueshëm e thatë. Sipërfaqet e çimentos duhen kurrar.
- Përdorni llaç riparues në rast se sipërfaqja e zbatimit nuk është e niveluar, për të përfunduar një sipërfaqe kompakte dhe të sheshtë. Përdorni astar mbi sipërfaqet e betonit të lehtësuar.
- Në rast se sipërfaqja e pasme e pllakës ka pluhur, fshijeni me leckë të lagur.
- 25 kg MA-405 MATIFLEX duhen zbrazur me ngadalë në 7,00 – 7.75L ujë të pastër dhe duhen përzierë derisa të përftohet një masë homogjene, pa kokrriza. Për përzierjen rekomandohet të përdoret një mikser me xhiro të ulëta. Nuk duhet shtuar asnjë aditiv (lëndë shtesë) që nuk është i shkruar në udhëzimin për përdorimin e produktit.
- Llaçi i përgatitur duhet lënë 5-10 minuta për t'u bërë gati për përdorim. Pas 1-2 minuta ripërzierje, është gati për aplikim.
- Konsumi është 3-5 kg/m².
- Përdoreni llaçin e përgatitur brenda 6 orëve.

-Përhapeni llaçin mbi sipërfaqen e zbatimit me pjesën e dhëmbëzuar të mallës, madhësia e dhëmbëve të së cilës përshtatet me përmasat e pllakës. Për të përfunduar një ngjitje të mirë, fillimisht aplikoni një shtresë të hollë MA-405 MATIFLEX me anën e sheshtë të mallës dhe më pas me anën e dhëmbëzuar të saj. Veçanërisht kur kërkohet aplikimi i pllakave të mëdha (më të mëdha se 40x40cm), mbi pllaka ekzistuese ose që janë të ekspozuara ndaj ngricave apo trafikut të rënduar, MA-405 MATIFLEX duhet aplikuar edhe në pjesën e pasme të pllakave (metoda e kombinuar e ngjitjes).

- Koha e ngjitjes është 30 minuta. Vendosini pllakat brenda këtij afati, duke ushtruar forcë. Kushtet jo të favorshme klimaterike (temperatura e lartë, lagështia e ulët, era, etj.) mund ta reduktojnë këtë kohë në vetëm pak minuta. Nëse tejkalohe ky afat, gërvishteni dhe hidhjeni poshtë llaçin.
- Mbushjen e fugave bëjeni pasi të kenë kaluar 24 orë nga shtrimi i pllakave në mur dhe 48 orë në dysheme.
- Dyshemeja mund të lejohet për përdorim 24 orë pas mbushjes së fugave.
- Hidhni poshtë llaçin të cilit i ka skaduar koha e përdorimit. Lajini mjetet e punës dhe duart me ujë, ndërsa sipërfaqet me një leckë të lagur.
- Pllakat e vendosura me MA-405 MATIFLEX nuk duhet të kenë kontakt me ujin të paktën për 24 orë.
- Temperatura e zbatimit të produktit dhe kushtet e magazinimit duhet të jenë ndërmjet +5°C dhe +35°C.

Jetëgjatësia në Raft

12 muaj në ambient të thatë dhe ambalazh të pahapur.

Magazinimi

Të ruhet në vend të thatë. Thasët të vendosen në stiva e shumta me nga 10 kate.

SKEDA TEKNIKE (NË +23°C DHE 50% RH.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri/E bardhë
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal të mbyllur, në një vend të thatë
Raporti I përzjerjes	6.5-7.5 litra ujë / 25 kg pluhur gri 7-7.5 litra ujë / 25 kg pluhur I bardhë
Temperatura e aplikimit	(+5°C) - (+35°C)
Trashësia e aplikimit	Deri në 10mm
Koha e punueshmërisë	6 Orë
Rrëshqitshmëria (EN 12004-2)	≤0.5mm
Koha e hapjes (EN 12004-2)	Pas 30 minutash ≥ 0.5 N/mm ²
Forca e ngjitjes (EN 12004-2)	
- Fillestare	≥ 1 N/mm ²
- Pas ekspozimit ndaj nxehtësisë	≥ 1 N/mm ²
- Pas zhytjes në ujë	≥ 1 N/mm ²
- Pas cikleve të ngrirjes/shkrirjes	≥ 1 N/mm ²
Deformueshmëria (EN 12002)	≥ 2.5mm – S1 E Deformueshme
Shkalla e temperaturës	(-40°C) - (+80°C)
Reagimi ndaj zjarrit	A2
Substanca të rrezikshme	Shiko SDS